

VENDIM
Nr. 912, datë 22.12.2014

PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN “RSM” TË NATO-S, PRANË KOMANDËS SË BATALIONIT SHUMËKOMBËSH, NË AFGANISTAN¹

(Ndryshuar me VKM nr.283, datë 21.5.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të *personelit* të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga 66 (*gjashtëdhjetë e gjashtë*) ushtarakë, pranë Komandës së Batalionit Shumëkombësh, në varësi të Shtabit të Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Kabul (TAAC - Capital), në Afganistan.

2. Misioni i *personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë* është ruajtja e Aeroportit Ndërkombëtar të Kabulit (KAIA), në kuadër të operacionit të NATO-s “RSM”, në Afganistan.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të *kontingjentit* të parë në Afganistan. Periudha e qëndrimit në mision për çdo *kontingjent* do të jetë me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik).

4. Venddislokimi i *personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë* të jetë në Aeroportin Ndërkombëtar të Kabulit (KAIA), në Afganistan.

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

- a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
- b) sigurimin e jetës;
- c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;
- ç) mbështetje shëndetësore;
- d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;
- dh) transport;
- e) aktivitete social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;
- ë) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit, që do të shërbejë në Afganistan, dërgimi, ndërrimi dhe kthimi pas përfundimit të detyrës për në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria, transporti i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy - ose shumëpalëshe ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ VKM nr. 912, datë 22.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.204, datë 7 janar 2014.
VKM nr.283, datë 21.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare 76, datë 28 maj 2018.

